

Hyrje

Investimet lokale mund të realizohen përmes më shumë modeleve, siç janë partneriteti publiko-privat, ndërmarrësia sociale dhe shërbimet sociale, ndërmarrjet me përgjegjësi shoqërore, donacionet filantropike dhe modelet tjera joformale me qëllim të plotësimit të nevojave të popullatës lokale nga më shumë fusha, siç janë mjedisi jetësor, shëndetësia, arsimi, gjendja sociale dhe ekonomike e banorëve. Që të kuptohet se si mund të funksionojnë investimet kapitale në komunitet, është e dobishme që të hulumtohen modelet ekzistuese.

Investimet në komunitet janë shpesh komplekse, konsumojnë kohë dhe janë të ngarkuara politikisht, duke balancuar interesat e shumë palëve të interesuara dhe duke përzier shumë burime të ndryshme kapitali me kufizime dhe kërkesa të ndryshme. Ato mund të kërkojnë bashkëpunim intensiv midis banorëve lokalë, bizneseve, filantropëve dhe palëve të interesuara të sektorit publik.

Gjatë analizës së mekanizmave të bashkëpunimit, u vu re se problemet më të shpeshta me të cilat përballen partnerët janë: mungesa e një politike kombëtare për bashkëpunim dhe koordinimi i dobët vertikal në institucionet publike; qasje jo gjithëpërfshirëse për zbatimin e politikave të zbatuara nga shërbimet publike; dhe rregulla të papërcaktuara të përgjegjësisë.

Në bazë të analizave dhe të dhënave të marra nga anketa për bashkëpunimin në komunitet, u hartuan kompanitë, me të cilat u kryen intervista gjysmë të strukturuar. Intervistat synonin të jepnin informata më të detajuara mbi investimet në komunitet bazuar në indikatorët kryesor të standardizuar të përcaktuar në Shtojcën 1.

Indikatorët kryesor u përcaktuan në bazë të hulumtimit nga zyra mbi praktikat e mira për përfshirje dhe bashkëpunim me palët e interesuara lokale në komunitet gjatë investimeve. Ato synojnë të lehtësojnë matjen, të paraqesin optimizimin e performancës në investimet në komunitet dhe të paraqesin mundësi për investime me ndikim. Indikatorët kryesorë të standardizuar ishin:

- ▶ Qasja strategjike e ndërmarrjeve në investime,
- ▶ Harmonizimi i investimeve me nevojat e komunitetit,
- ▶ Bashkëpunimi me aktorët relevant në komunitet,
- ▶ Qëndrueshmëria e investimeve në komunitet, dhe
- ▶ Matja e investimeve.

Në bazë të intervistave me ndërmarrjet, u përgatitën tre raste studimore të ndërmarrjeve që investojnë në komunitet, me qëllim që të përshkruhen hollësisht dhe të analizohen investimet në bazë të indikatorëve kryesor të standardizuar të identifikuar më parë.

Dauti Komerc

Dauti Komerc është ndërmarrje e cila (nga vetë fillimi i themelimit) që nga vitet e para të ekzistimit të vet investoi në komunitet. Në fillim të punës së vet, mjetet financiare për mbështetje të komunitetit janë ndarë si pjesë nga fitimi dhe është ndihmuar në të gjitha aspektet e jetës lokale të komunitetit lokal. Mbështetja ka pasur qëllim humanitar.

Me rritjen e të hyrave të ndërmarrjes ka filluar të rritet edhe mbështetja. Mbështetja ka qenë e orientuar drejt kategorive të cenueshme të popullatës, arsimit, kultura, sporti, aktivitete fetare etj. Deri në vitin 2010 investimet janë bërë pa strategji, pa plan, pa menduar në mënyrë sistematike për qëndrueshmërinë e investimeve dhe pa mundësinë që të matet ndikimi nga investimet.

Investim për përmirësimin e ekologjisë dhe riciklimit të mbeturinave

Kishite një sfidë për ndërmarrjen në drejtim të menaxhimit të mbetjeve nga puna afariste. Edhe institucionet publike kishin interes për reduktimin e mbetjeve në komunitet, por nuk kishin kapacitete për të ndihmuar ndërmarrjet në zgjidhjen e problemit. Mbetjet nga druri, letra, najloni dhe kanaçet metalike ishin një problem si për ndërmarrjen ashtu edhe për komunitetin. Për zgjidhjen e këtij problemi, ndërmarrja ka bërë një plan biznesi për investime në komunitet, i cili do të ndihmojë komunitetin, dhe në të njëjtën kohë do të zgjidhë një nga objektivat e biznesit të ndërmarrjes.

Plani i biznesit për menaxhimin e mbetjeve përfshinte investimin në një fabrikë për riciklimin e mbetjeve për përdorim të mëtejshëm, marrjen e licencës për menaxhimin e mbetjeve dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të banorëve vendas dhe ndërmarrjeve për riciklimin e mbetjeve. Ky investim zgjidhi problemin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja përmes takimeve joformale me banorët ndikoi në edukimin e popullatës për riciklimin e mbetjeve dhe forcimin e vetëdijes për ruajtjen dhe mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm. Si rezultat i edukimit, popullata u përfshi më shumë në aktivitetet për pastrimin e mbeturinave në komunitet, e një ndër to është aksioni për pastrimin e plotë të fshatit Bojanë. Popullsia vendase e pranoi iniciativën dhe filloi riciklimin e mbetjeve. Hapi tjetër ishte investimi në kazanët e riciklimit të mbetjeve përballë marketeve më të mëdha. Pavarësisht se sasia e mbetjeve është rritur, investimi në periudhën e ardhshme pritet të jetë fitimprurës dhe i vetë qëndrueshëm. Qëllimi është që riciklimi i mbetjeve të bëhet pjesë e kulturës së popullsisë dhe ndërmarrjeve të zonës.

Investimi është bërë në përputhje me planin e projektit, është i harmonizuar me nevojat e banorëve të komunitetit dhe planin e biznesit të ndërmarrjes, i përfshin banorët e komunitetit si partnerë të barabartë dhe siguron angazhimin e tyre për të përmirësuar nevojat e tyre, është i matshëm dhe i qëndrueshëm.

Investime në arsim

Dauti Komerc si ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore ka shumë vite që ndihmon në zhvillimin dhe përmirësimin e edukimit të grupeve të cenueshme. Investimet në arsimin e komunitetit lokal kanë një ndikim të fortë në produktivitetin e punës dhe përshtatjen e ofertës së punës sipas nevojave të ndërmarrjes, reputacionit të ndërmarrjes dhe ofrojnë një avantazh konkurrues për ndërmarrjen.

Vetë zhvillimi i ndërmarrjes shpie në krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e situatës së papunësisë në komunitetin lokal. Kontribuon në zhvillimin strategjik ekonomik lokal. Interesat e institucioneve vendore dhe të banorëve për investime në arsim janë të mëdha, por ata janë të vetëdijshëm se nuk ka mjete të mjaftueshme financiare dhe kapacitete institucionale për realizimin e tyre.

Deri në vitin 2010 mbështetja e popullatës në arsim realizohej pa qasje sistematike, ekskluzivisht për arsye humanitare. Por gjatë investimeve ka raste kur mbështetja e personave për arsimin nuk i arrin qëllimet dhe abuzohet me të. Si rezultat, ndërmarrja fillon të bëjë një plan dhe strategji për të orientuar investimet në arsim në mënyrë që të ketë një efekt më të madh si tek banorët ashtu edhe tek komuniteti në të njëjtën kohë.

Për të pasur një qasje sistematike dhe më efektive në mbështetjen e komunitetit lokal në vitin 2010, ndërmarrja Dauti Komerc e themeloi Fondacionin Albiz, i cili në vitet e para mban emrin e kompanisë. Qëllimi kryesor i themelimit të Fondacionit Albiz (në tekstin e mëtejshëm - Fondacioni) është planifikimi i zbatimit të aktiviteteve të investimit në komunitet, si bursa për kategoritë e cenueshme, edukimi joformal i popullatës, mbështetja e sportit dhe kulturës etj.

Me krijimin e Fondacionit u reduktuan aktivitetet dhe investimet direkte nga ndërmarrja. Ndërmarrja Dauti Komerc para fillimit me punë të Fondacionit Albiz vazhdimisht ka investuar në arsimimin e 200 deri në 300 personave dhe pasi Fondacioni ka marrë përsipër investimet, ndërmarrja ofron mbështetje për 20 deri në 30 persona. Popullata vendase është e informuar për aktivitetet dhe qëllimet e Fondacionit, në mënyrë që nevojat për investime në arsim të ridrejtohen tek Fondacioni.

Me punën e vet, Fondacioni bëhet i vetë qëndrueshëm dhe e redukon varësinë e tij nga donacionet e investitorëve. Ai mund të masë dhe ta prezantojë punën e tij.





bashkëpunimi i mëparshëm i ndërmarrjes me kompani të tjera që kanë nevojë për e-tregti dhe marketing digjital në industrinë e IT.


Në vitin e parë pas shpalljes kanë aplikuar për trajnim rreth 100 persona, nga të cilët janë përzgjedhur 30 persona. Pas intervistave u përzgjedhën 13 persona të cilët morën pjesë dhe përfunduan trajnimet. Pas përfundimit të trajnimeve, të gjithë personat janë punësuar.


Institucionet publike dhe banorët e lagjeve të varfra i shohin përfitimet për komunitetin nga ky lloj investimi, por u mungojnë burimet financiare dhe kapacitetet institucionale për t'i zbatuar ato.

Ky investim ka pasur një qasje strategjike të përcaktuar përmes një plani biznesi, ka rezultuar të jetë i qëndrueshëm dhe mënyra se si është realizuar investimi tregon se përveç qëllimeve të biznesit ai i plotëson nevojat e komunitetit lokal dhe mund të masë dhe prezantojë ndikimin tek palët e interesuara.



ФРИЛЕНСИНГ ВО 2020: КАКО ДА ГО ОСВОИШ ПРВИОТ КЛИЕНТ?





Pokrov

Pokrov është një ndërmarrje sociale që prodhon produkte organike përmes një programi rehabilitimi për të varurit. Ndërmarrja sociale ka rreth 50 të punësuar apo të angazhuar dhe një investim prej rreth një milion eurosh. Shumica e aktiviteteve ekonomike kanë një ndikim të fortë tek banorët e komunitetit.

Rehabilitim profesional për punësim

Pokrov zbaton një program afatgjatë rehabilitimi për varësinë nga droga, alkooli dhe lojërat e fatit në Maqedoni, i hapur në vitin 2009, i strukturuar sipas parimit të komuniteteve terapeutike botërore. Programi është i orientuar drejt aplikimit të identitetit negativ të personave me probleme të varësisë nëpërmjet disa drejtimeve psiko-terapeutike. Ndërmarrja sociale po zhvillohet në Pokrov në kuadër të programit të komunitetit terapeutik. Kjo qasje promovon ndryshime pozitive sociale dhe përfshirje sociale të të gjithë klientëve që do të përfundojnë tërësisht me sukses programin, për të fituar mundësi punësimi në ndërmarrjen.

Komponenti ekonomik i organizatës është në pjesën e shitjes së prodhimit organik të produkteve bujqësore, nëpërmjet të cilit realizon të ardhura. Për ata që kanë përfunduar programin dhe duan të qëndrojnë për të ndihmuar dhe punuar në Pokrov, punësimi sigurohet përmes aktiviteteve ekonomike.

Pjesëmarrësit kanë përfitim të dyfishtë nga aktivitetet ekonomike, sepse përmes tyre realizohet terapia profesionale dhe fitohen ose forcohen shprehitë e punës, si dhe organizata gjeneron të ardhura dhe krijon vende pune.

Shitja ofrohet nëpërmjet bashkëpunimit me rrjetet më të mëdha të supermarketeve në vendin ku janë vendosur produktet. Të gjitha investimet e biznesit të kryera nga ndërmarrja fillojnë me përgatitjen e një plani biznesi nga konsulentë me përvojë. Plani i investimeve të biznesit përfshin analizën e tregut, strategjinë e prodhimit, mënyrën e sigurimit të burimeve financiare, përfshirjen e palëve të interesuara dhe parashikimet financiare.

Në fillim të investimit ka një periudhë testimi për nga vëllimi i prodhimit, numri i të punësuarve dhe pajisjet e makineritë e nevojshme. Pas përfundimit të investimeve në përputhje me planin e biznesit monitorohet dhe mund të prezantohen rezultatet e aktiviteteve të biznesit.

Bashkëpunimi me institucionet publike është në nivel të mirë dhe në shumë raste institucionet publike mbështesin aktivitetet e ndërmarrjes. Ndërmarrja ka bashkëpunim të mirë edhe me organizatat ndërkombëtare që e njohin ndikimin që ka ndërmarrja sociale në komunitet.





Hotel Skardus

Hoteli Skardus u themelua në vitin 2013 nga dy vëllezër të cilët i kanë investuar financat dhe përvojën e tyre për të krijuar një brend të ri në Qendrën e Skijimit – Kodra e Diellit. Faza kryesore e zhvillimit të kompanisë ndodhi në vitin 2017 me një ndryshim në strategjinë e menaxhimit. Në vend të promovimit të akomodimit dhe ushqimit standard, aktivitetet kryesore kishin për qëllim krijimin e ofertave aventureske për ski falas, angazhimin gjithë ditë për turistët me guida dhe shëtitje me këpucë dëbore në pistat e egra të skijimit të Malit Sharr.

Strategjia për përfshirjen e ofertave të aventurës ka treguar rezultate të mëdha, ndaj në vitin 2021 hoteli investon në çiklizëm malor në zonat e afërta dhe më gjerë. Hoteli ka rreth 40 të punësuar (ky numër ndryshon në varësi të sezonit). Menaxhmenti përbëhet nga bashkëpronari i hotelit, Hashim Hasani, i cili i menaxhon ofertat, stafin dhe zbatimin e strategjisë dhe bashkëpronarin tjetër, Hajrulla Hasani, i cili është i përfshirë me ekspertizën e tij në krijimin e strategjive. Vizioni i kompanisë dhe të gjithë palëve të interesuara në rajonin e Malit të Sharrit është që të bëhet një destinacion turistik katër-sezonal.

Për herë të parë, palët e interesuara po punojnë fort për të krijuar produkte të përbashkëta, madje edhe produkte ndërkufitare, për të krijuar Organizata të menaxhimit të destinacioneve me qëllim zgjerimin e ofertës së produkteve turistike, veçanërisht në verë. Skardus si kompani, punon intensivisht për të përfshirë në ofertat e saj paketa të ndryshme, si biçikleta elektrike, ski, kalërim, vëzhgim zogjsh, instalim kamerash kurthi për florën në male dhe vizita shkencore për botanistët.

Shembuj të intervenimit më komunitet

Hotel Skardus, përmes aktiviteteve dhe ofertave të tij aventureske ka ndikuar shumë në edukimin e banorëve për turizmin malor dhe atë alternativ. Destinacionet fillestare me çiklizmin malor dhe kontakti i turistëve të huaj me popullsinë vendase, të cilat kontribuan që një pjesë e popullsisë t'i bashkohej zinxhirit të destinacionit turistik, si furnizues dhe si pjesë e fuqisë punëtore dhe ekspertizës për menaxhimin e turnet turistike, dhe në këtë mënyrë të rrisë standardin e popullsisë në këto zona.

Rezultati i këtyre ofertave është edukimi i popullatës për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, në kuadër të investimeve në komunitet, ata kontribuan në krijimin e shtigjeve të reja për biçikleta, duke i rregulluar, hartuar, shenjzuar me tabela dhe harta digjitale, informacion ky i nevojshëm për një grup më të madh dhe jo vetëm për klientët e hotelit.

Hoteli nuk mendon vetëm të rrisë cilësinë e shërbimit brenda, por ka vendosur të investojë në zonën e Kodrës së Diellit me një investim prej rreth 20 mijë eurosh në higjienë dhe ndriçim rrugor. Ky investim nga hoteli i jepet vetëqeverisjes lokale. Po ashtu e ka riparuar edhe rrugën lokale nga qendra e skijimit deri te vetë hoteli, në një gjatësi prej 500 m, duke zhvendosur kanalin e ujërave të rrëmbyeshëm, me kanal të ri, shtrimin e rrugës dhe ndriçimin e rrugëve në këtë pjesë, gjë që ka përmirësuar infrastrukturën, shtohen vendet e parkimit në stinën e dimrit dhe rrisin sigurinë e vizitorëve në këtë vend turistik.

I gjithë investimi iu kthye nga fakti se nga një hotel në periferi të Qendrës u kthye në një vend qendror për t'u vizituar në këtë qendër turistike. Për sigurinë e vizitorëve, hoteli ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, si dhurimi i fondeve për kompanitë që kujdesen për qentë endacak, për të mos rrezikuar vizitorët.

Gjithashtu Skardus disponon 15 mjete motorike për sezonin e dimrit dhe kur bie borë dhe autoritetet komunale nuk arrijnë t'i përballojnë, si zgjidhje urgjente këto mjete vihen gjithmonë në dispozicion për pastrimin e borës, gjurmimin e terrenit me borë për të shpëtuar turistët nga orteku ose bllokim në stuhi dëbore.





Slice Maqedoni

Slice Maqedoni është një kompani e përkushtuar për të ndihmuar piceritë e pavarura të konkurrojnë me zinxhirët e mëdhenj të picave, duke ofruar teknologji të thjeshtë të porositjes në internet, marketing të personalizuar në dyqan dhe reklamim digjital të personalizuar.

Në Maqedoni, ekipi i Slice është në kontakt të drejtpërdrejtë me partnerët dhe klientët e tyre në SHBA çdo ditë. Ekipet në Ohër dhe Dibër punojnë drejtpërdrejt me zyrat në Nju Jork dhe Belfast për të koordinuar përpjekjet e mbështetjes, marketingut, inxhinierisë dhe informacionit. Për shkak se është një kompani që është rritur me shpejtësi në 10 vitet e fundit, me mbi 800 të punësuar në Dibër, Ohër dhe Shkup, numri i kërkesave për mbështetjen e tyre në segmente të ndryshme të nevojave të shoqërisë është rritur gjithashtu me shpejtësi.

Shumica e ndërhyrjeve kanë për qëllim sportin, kulturën, ekologjinë, si dhe ndihmën e drejtpërdrejtë për kategoritë e cenuara, por edhe ndërhyrjet kanë për qëllim përmirësimin e disa grupeve potenciale që mund të jenë në të ardhmen dhe pjesë e vetë kompanisë.

Investime në arsimin joformal

Strategjia e biznesit e kompanisë është të krijojë një bazë të punësuarish të mundshëm, të cilët kanë njohuri solide të gjuhës angleze për të qenë në gjendje të komunikojnë me klientët në Shtetet e Bashkuara.

Pjesa kryesore e aktiviteteve të tyre është e orientuar drejt ndërmjetësimit në shitje dhe produkteve ushqimore, dhe synimi i tyre është fuqia punëtore e trajnuar. Për këtë, ata kanë punësuar mësues të gjuhës angleze, të cilët trajnojnë të punësuarit e tyre në bazë ditore, por nuk kufizohen vetëm me të punësuarit e tyre, por kurset mund të ndiqen nga njerëz jashtë fushëveprimit të tyre dhe trajnimi është falas me kontrata jodetyruese.

Kjo qasje e kompanisë është në dobi edhe të qëllimeve të tyre afariste, sepse në të njëjtën kohë ata krijojnë një staf profesional, i cili shumë lehtë mund të përfshihet në aktivitetet e përditshme të kompanisë dhe në këtë mënyrë të ketë vazhdimësi në ofrimin e shërbimeve.

Në 6 muajt e ardhshëm plani afatshkurtër i kompanisë është krijimi i një akademie të brendshme, e cila do të funksionojë në mënyrë më të organizuar, ku përveç gjuhës angleze do të mësohet edhe programimi, analiza e të dhënave etj. Kjo është në përputhje me zgjidhjen e çështjeve të zbuluara në hulumtimin e tyre për nevojat për zhvillim të ndërmarrjeve, sepse fuqia punëtore në Maqedoni ka potencial të madh, shumë të arsimuar, por edhe mungesë të përvojës. Kompanitë e huaja kanë nevojë për staf që është në trend me zhvillimet në botë.

Në botë trendët po ndryshojnë, në Amerikë dhe Evropë mundësitë janë shumë më të mëdha se tregu maqedonas. Inxhinierët dhe zhvilluesit nga Maqedonia duhet të trajnohen më tej në përputhje me trendët në tregjet e huaja. Ideja e kompanisë është që të investojë në krijimin e një profili të tillë punëtorësh.

Investime në sport dhe kulturë

Pjesa e investimeve në sport dhe kulturë është e orientuar kryesisht në mbështetjen e klubeve sportive si klubi i futbollit Korab i cili financohet prej 4 vitesh, Shqiponjat e Dibrës - klubi i basketbollit për femra dhe klubi i kajakut. Mbështeten edhe ngjarje kulturore, artistike dhe ngjarje të tjera si Festivali i shfaqjes në Dibër, Fshati i Fëmijëve SOS dhe Maratona e Ohrit.

Këto investime nga pikëpamja strategjike ishin planifikuar për të promovuar veten si një kompani relativisht e re në treg, veçanërisht në qytetet e Shkupit dhe Ohrit, në mënyrë që të mund të tërheqin më shumë të rinj për t'u punësuar në kompania.

Investimet janë në përputhje me nevojat e komunitetit dhe zakonisht gjatë zbatimit të tyre kompania konsultohet me organizatat e shoqërisë civile që e zbatojnë atë dhe kompania i mbulon kostot financiare.



SLICE



02.07.2017
(e diel)



09:00h
Nisja prej te Sheshi Skenderbej

- * Cleaning Lake
- * Job Applications
- * Pizza Party & Drinks





Fortesa

Kompania Fortesa-El, është themeluar në vitin 1999 me seli në Tetovë. Deri më tani ka kryer dhe projektuar faza të instalimeve elektrike në disa objekte të mëdha publike dhe tregtare në vend. Ajo njihet për disponimin e makinerive të ndërtimit dhe pajisjeve të tjera të nevojshme, si dhe inxhinierë me licenca A dhe B, të cilat janë ekspertiza kryesore e kompanisë dhe që shpeshherë janë në dobi të komunitetit. Në varësi të punës në terren, numri i të punësuarve shkon deri në 25 të punësuar në vit.

Investime në komunitet

Si kompani për instalime elektrike dhe projektim, ajo ia lë në dispozicion burimet e saja për të mirën e komunitetit, veçanërisht ekspertizën që e zotëron. Shembull konkret është donacioni për komunën e Tetovës për investim në infrastrukturën e Kodrës së Diellit. Qëllimi i projektit falas me vlerë 15-20 mijë euro është që të mund të aplikohen në fonde të jashtme për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Gjithashtu për Komunën e Tetovës është bërë projektimi i kanalizimit, ujësjellësit të pjesshëm. Me investimin e bërë në komunitet synohet të tregohet se fitimi i realizuar nga përfaqësuesit e komunitetit, një pjesë e tij shkon në përmirësimin e cilësisë së jetës, me një mesazh për ato biznese me të cilat kemi punuar, se bashkëpunojnë me një kompani me përgjegjësi shoqërore.

Me këtë edhe vetë komuniteti ndihet më i sigurt sepse në krijimin e strategjisë kryesore të komunës për trajtimin e problemeve dhe çështjeve të përditshme të komunitetit nuk janë vetëm analizat komunale, strategjitë specifike dhe dizajni. Modeli i ndërhyrjes së komunitetit

kryesisht konsiston në veprimin në ato pjesë ku shërbimet komunale nuk kanë mundësi të ndërhyjnë.

Fortesa ka bashkëpunim të ngushtë me komunën dhe problemet kryesore janë evidentuar sa i përket çështjeve të infrastrukturës. Nga përvoja, gjetjet tregojnë se për gjetjen e investitorëve potencialë për intervenime në komunitet, përgatitja e dokumentacionit teknik për investime është problematike. Këtu e gjithë ekspertiza e kompanisë vihet shpesh në shërbim të shoqërisë me përgatitjen falas të dokumentacionit të investimit.

Sa herë që shërbimet teknike të vetëqeverisjes lokale ngecin për një çështje, përdorin Fortesën dhe ekspertizën e të punësuarve të saj si pikë referimi. Në periudhën e përgatitjes së buxhetit vjetor të komunës, nga shtatori deri në nëntor, ata gjithmonë ndajnë kohë për t'i ndihmuar me ekspertizën që kanë në fushën e tyre.

Sa herë që ka një emergjencë, kompanitë që kanë një aktivitet të ngjashëm si Fortesa, vetë organizohen dhe koordinohen dhe merren me atë situatë së bashku. Për shembull, për të ndihmuar komunën në trajtimin e një problemi të caktuar, si heqja e borës etj., që mund të jetë një ndërhyrje gjithë ditën ose javën, kompanitë pjesëmarrëse në intervenim e ndajnë punën në 8 orë.

Kompania e ndihmon komunitetin dhe organet komunale në përcaktimin dhe plotësimin e qëllimeve të tyre nëpërmjet planifikimit me pjesëmarrje dhe këshillave vendimmarrëse. Me rastin e rregullimit të pistave të skijimit nga ELEM kompania Fortesa ka ndihmuar në gjurmimin e plotë dhe vendosjen e ndriçimit sipas normave për ndriçim të tillë.

Fortesa ka 15 automjete për ndërtim dhe punë të ngjashme. Ndërmarrja komunale për mirëmbajtjen e infrastrukturës, sa herë që nuk mund të zgjidhë një problem me objektet e veta, kërkon mbështetje nga kompania, duke përdorur fondet e saj, pa kompensim.

Shoqata “Pablik”

Shoqata për kërkim, komunikim dhe zhvillim, “Pablik”, është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse që nxit ndryshime pozitive shoqërore duke zhvilluar sipërmarrjen sociale dhe duke nxitur përfshirjen sociale përmes kërkimit, avokimit dhe krijimit participativ të politikave publike. Fokusi i saj është në ndërtimin e ndryshimeve pozitive shoqërore dhe një shoqëri të fortë civile.

Shoqata “Pablik” ka krijuar instrumentin e parë inovativ për matjen e ndryshimit shoqëror të organizatave qytetare. Qëllimi i këtij instrumenti është t'u mundësojë organizatave qytetare të përcaktojnë kapacitetin e tyre për të nxitur ndryshimet shoqërore. Ata mbrojnë një shoqëri me mundësi të barabarta për të gjithë.

Kohezioni social dhe ndërlidhja dhe integrimi i personave të margjinalizuar

Brendi më i dukshëm i “Pablik” është revista “Ballë për ballë” e cila është kthyer në një mjet avokimi dhe komunikimi në ndërgjegjësimin e publikut për tema të rëndësishme shoqërore si: përfshirja, edukimi, të drejtat e njeriut, inovacioni social, integrimi, strehimi, etj. Sot revista shpërndahet në disa qytete të Maqedonisë, përmes një rrjeti partner prej 10 organizatash.

Strategjia për zhvillim të qëndrueshëm e “Ballë për ballë” bazohet në hulumtimin e bërë në Maqedoni, por edhe në njohuritë e përgjithshme të shembujve të praktikës së mirë të funksionimit të revistave botërore në rrugë, ndaj të cilave aktivitete synon “Ballë për ballë”. Institucionet shtetërore dhe publike janë abonentë të revistës për të kontribuar në qëndrueshmërinë e nismës, megjithëse vetë qëndrueshmëria është një sfidë që duhet adresuar në të ardhmen.

Qëllimet kryesore të modelit të sipërmarrjes sociale janë të ofrojë zgjidhje praktike për uljen e varfërisë, rritjen e punësimit dhe zbutjen e përjashtimit social dhe kulturor, krijimin e

kushteve dhe mundësive për grupet e marginalizuara për të fituar ligjërisht të ardhura, për të punësuar dhe për të inkurajuar njohuri specifike dhe aftësitë të zbatueshme, p.sh. për përfshirje sociale dhe ekonomike, si dhe nëpërmjet drejtimit dhe botimit të rregullt të një reviste të pavarur.

Vetë modeli ka një rol të dyfishtë, d.m.th. forcon kategoritë e cenuara të qytetarëve, por edhe ndërgjegjëson publikun për çështje që na prekin të gjithëve, si: përfshirja sociale, politika sociale, demargjinalizimi i grupeve dhe individëve, arsimi, mjedisi, ndërgjegjësimi, zhvillimi kulturor, aktivizimi në art dhe kulturë, përgjegjësia sociale, vullnetarizmi, të cilat janë disa nga temat që janë në fokusin e interesit të revistës.

Revista është një hap pionier në sipërmarrjen sociale në vend duke u mundësuar kategorive të marginalizuara dhe të cenueshme të qytetarëve për të fituar, arsimim, demargjinalizimin dhe përfshirje. Gjysma nga vlera e revistës (që kushton 100 denarë) shkon tek shitësi, kurse gjysma për shtypje dhe aktivitete që përmirësojnë jetën e grupeve të marginalizuara.

Gjithashtu një revistë mjedisore që shtypet në letër të ricikluar dhe lufton për një shoqëri në të cilën ekonomia dhe mjedisi do të funksionojnë në harmoni dhe i inkurajon kompanitë të jenë të përgjegjshme shoqërore.

Projekti ka edhe ueb faqen e tij, dhe për shkak të pandemisë gjatë vitit 2020, “Ballë për ballë” po e zhvillon edicionin e tij digjital përmes të cilit lexuesit mund të abonohen dhe të marrin revistat në shtëpitë e tyre ose t’i dhurojnë.



ЛИЦЕВЛИЦА

Број 044//година 2021 // ISSN 1857-8306 // цена 100 денари // половина добива продавачот

СПИСАНИЕ ЗА
ОДРЖЛИВ
РАЗВОЈ



Pika Arhitekt

Kompania “Vezë Sharri”, nga rajoni i Pollogut, ka përkrahur studentët e rinj për të projektuar një qendër sportive rekreative në Zhelinë. Janë punësuar gjithsej katër studentë, dy prej të cilëve kanë vazhduar të punojnë me Vezë Sharri, duke themeluar kompaninë Pika. PIKA ARHITEKT funksionon që nga viti 2015 si rezultat i një rasti pothuajse identik të ndërhyrjes së komunitetit nga Vezë Sharri.

Prej atëherë janë zbatuar më shumë se 100 projekte dhe disa prej tyre kanë të bëjnë me fondet ndërkombëtare, si fondet e BE-së dhe IPARD. Klientët janë nga sektori privat dhe publik, duke përfshirë komunat, shkollat dhe institucione të tjera të ndryshme. Sipas numrit të punësuarve, është një sipërmarrjeje e vogël, por ka shumë ndërhyrje që në një mënyrë apo tjetër janë pjesë e zgjidhjes së çështjeve kolektive që lidhen me komunitetin.

Intervenime lidhur me arsimin dhe edukimin

Strategjia e kompanisë për zgjerimin dhe rritjen e tyre konsiston në ndërhyrjen për ngritjen e kapaciteteve për të punësuarit e mundshëm të ardhshëm, përmes modelit të përfshirjes së studentëve në aktivitetet e tyre të përditshme, i cili është paksa i ndryshëm nga modeli standard i praktikës i zhvilluar në kompani të tjera.

Kompania investoi në krijimin e një mini-laboratori me mundësi për studentët që të punojnë me makina CNC, laser, prerës, printer 3D dhe pajisje të tjera të ngjashme që ishin tërheqëse për përfshirjen e studentëve.

Përkatësisht, kompania bashkëpunon me dy universitetet në Tetovë dhe studentët e tyre, të cilët përveç që marrin një shumë të caktuar për praktikën, kanë mundësi që praktikisht ta shfrytëzojnë laboratorin. Kompania po e zhvillon strategjikisht këtë koncept duke ofruar tokë të

re ndërtimore ku do të ndërtohet një laborator edhe më i madh, i cili do të jetë jo vetëm një zyrë projektimi, por edhe një qendër edukimi për inxhinierët e ardhshëm, si dhe të punësuarit e mundshëm të kompanisë.

Kompania ka një qasje specifike në arritjen e qëllimeve të biznesit, dhe këtë e bën duke mbështetur drejtpërdrejt investitorët potencial, duke i edukuar vazhdimisht ata për planifikimin hapësinor dhe punën administrative me pronat, të lidhura me planet detale dhe urbane. Kjo qasje ndaj implantimit të investimeve ka një ndikim pozitiv.

Edukimi bazohet në rezultatet e hulumtimit që tregojnë se institucionet janë të mbyllura për qytetarët, nuk ndajnë informacione me ta, dhe në të njëjtën kohë vetë qytetarët e Tetovës janë më pak aktivë, krahasuar me qytetet e tjera të vendit, për të marrë informacionin e nevojshëm lidhur me pronat e tyre.

Intervenime në projekte humanitare

Kompania, përveç mbështetjes së projekteve humanitare me burime financiare si pajisja e disa banesave sociale dhe shtëpive, vë në dispozicion edhe ekspertizën (projektimin, mbikëqyrjen) dhe pajisjet e tyre në zbatimin e këtyre projekteve.

Sa herë që kryhen këto lloj ndërhyrjesh, kompania dhe partnerët e saj janë të fokusuar në eliminimin e rreziqeve dhe mundësinë e qëndrueshmërisë së projektit. Duke qenë se donacione të tilla zbatohen për kategoritë e cenueshme shoqërore, ato gjithashtu përpiqen të sigurojnë përjashtime nga tatimi në pronë nga autoritetet lokale, ndonëse deri tani pa sukses. Gjithashtu ato mbrohen nga tjetërsimi apo shitja e mundshme e pronës nga pronari me klauzola të veçanta në kontratë, e cila mbron brezat e rinj të pronarit nga tjetërsimi i pronës.

Ekspertiza e tyre është përdorur edhe nga autoritetet komunale për projektim falas për rindërtimin e një shkolle fillore urbane dhe rurale në komunën e tyre.

Bashkëpunimi me projekte ndërkombëtare

Krahas projekteve komerciale, ekspertiza e tyre vihet në funksion të zbatimit të projekteve me karakter social. Në komunën e Vinicës janë bartës të aktiviteteve për legalizimin e 200 shtëpive të pjesëtarëve të komunitetit rom duke rregulluar dokumentacionin, asistuar me kurse dhe në partneritet me Qendrën Burimore Rome dhe Chelim, Itali.

Më shumë se 15 të punësuar nga ai komunitet u punësuan për të pastruar 22 shtëpi, për të riparuar sistemin e kanalizimit, një rrugë 300 metra me ndriçim diellor dhe për të rregulluar një plan urbanistik të detajuar.

Kjo përfshirje e suksesshme në intervenimin e komunitetit rezulton me përfshirje në intervenimet e radhës që do të realizohen në Prilep, Shtip dhe Berovë si rezultat i thirrjes së re. Kontributi i madh që kompania ka dhënë në këtë komunitet, mund të tregohet nga treguesi i kënaqësisë dhe respektit të përfaqësuesve të komunitetit ndaj kompanisë.

Green IT

Green IT është një Startup, i krijuar nga të rinjtë, të cilët në vitin 2020 do të lançojnë aplikacionin celular të quajtur “Challenger”. Produkti digjital, pra aplikacioni celular motivon dhe shpërblen njerëzit që ecin dhe ngasin biçikleta për të qenë në formë dhe të shëndetshëm, për të bërë diçka të mirë për shoqërinë, dhe në të njëjtën kohë planetin tokë d.m.th. i ndihmon njerëzit të shohin se si çdo aktivitet i vogël (si ecja, çiklizmi dhe përdorimi i transportit publik) përmirëson shoqërinë në mënyrë që të bëhen të përgjegjshëm shoqërorë.

Veprimi i tyre dhe krijimi i produkteve dhe shërbimeve të reja bazohet në vlerat e kompanisë, që do të kontribuojë në krijimin e komuniteteve dhe qyteteve të qëndrueshme dhe të gjelbra duke inkurajuar sjellje pozitive dhe të përgjegjshme të qytetarëve, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe së bashku në cilësinë e ajrit të jetë pjesë e reduktimit të ndotjes së ajrit.

Green IT i analizon rezultatet e arritura çdo tre muaj dhe i ndan të njëjtat publikisht me komunitetin e mediave sociale dhe profilet e tyre në rrjetet sociale.

Ato njihen gjithashtu nga Shoqata Konekt si një nga kompanitë që janë lidere në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe një shembull frymëzues i një kompanie që dëshmon në operacionet e saj të përditshme se biznesi mund të jetë një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm.


Nga ana tjetër, Green IT është përfshirë në aksionin humanitar “IT4Charity 2021” i cili është një projekt donator i kompanive të IT-së dhe është një organizatë sociale që ka filluar të funksionojë në vitin 2016. Qëllimi i saj është mbledhja e fondeve për personat që kanë nevojë dhe për realizimin e kësaj nisme janë organizuar edhe evente muzikore.

Qëllimi kryesor është të angazhohen kompanitë e IT në Maqedoni për të bashkëpunuar dhe marrë pjesë në një ngjarje për të arritur një qëllim më të madh dhe më human, për të treguar se kompanitë e IT dhe njerëzit që punojnë në industrinë e IT kujdesen për shoqërinë dhe janë të gatshëm të kontribuojnë dhe kontribuojnë në to. Ndihamoni ata që kanë nevojë.

Domethënë, qëllimi i këtij aksioni humanitar është që të ndihmohet fëmijët pa prindër dhe kujdesi prindëror i mbështetur nga SOS Fshati i Fëmijëve. Aplikacioni Challenger përdoret nga punonjësit e kompanisë për të matur kilometrat e kaluara në këmbë dhe me biçikletë.

Kilometrat e përbashkëta për kompani janë të shfaqura në faqen It4charity (challenger.mk), ndërsa kompanitë dhurojnë mjete për çdo kilometër të kaluar për punonjësit e tyre sipas SOS Fshati i Fëmijëve.

Gjatë këtij projekti u bashkuan 14 kompani IT dhe u dhuruan mbi 20 mijë euro. Periudha e aksionit humanitar “IT4Charity 2021” ka nisur më 15 korrik dhe do të zgjasë 5 muaj, deri në fund të dhjetorit.




Што е IT4Charity 2021?

За секој изминат километар од вработените, пешки или на велосипед, IT компаниите донираат за СОС ДЕТСКО СЕЛО

ги броиме зелените километри....





Shtojca 1.

Indikatorët për investime në komunitet

1. Qasja strategjike e ndërmarrjeve në investime

1.1 **Indikator:** Investimi është bërë në bazë të strategjisë të shkruar dhe/ose vizionit lidhur me një Projekt të qartë investimi.

Arsyetimi për indikatorin:

Indikatorin duhet të tregojë se aktivitetet në investim dalin nga strategjia mirë e përcaktuar, që përshin objektivat, kriteret dhe parimet.

1.2 **Indikator:** Projekti për investim i përfshinë periudhën kohore, buxhetin e investimit, qasjen e partnerëve lokal, përputhshmërinë e investimit me qëllimet e biznesit dhe mënyrën e përdorimit të burimeve të ndërmarrjes në mënyrë më efektive.

Arsyetimi për indikatorin:

Indikatorin duhet të tregojë se investimi nuk është i fokusuar vetëm në burimet financiare. Investimi duhet të synojë të përdorë sa më mirë asetet, burimet, ekspertizën dhe marrëdhëniet e ndërmarrjes për të mirën e komuniteteve lokale. Ai duhet të fokusohet në disa fusha kyçe ku ndërmarrja mund të shfrytëzojë sa më shumë rolin dhe kompetencat e saj për të përmbushur prioritetet e komunitetit.

2. Harmonizimi i investimeve me nevojat e komunitetit

2.1 Indikator: Investimi është harmonizuar me prioritetet e komuniteteve lokale, shoqërinë civile dhe institucionet publike në drejtim të krijimit të “vlerës së përbashkët” (dobi edhe për ndërmarrjen, banorët dhe institucionet publike).

Arsyetimi për indikatorin:

Indikatori duhet të tregojë se me investimin plotësohen nevojat e komunitetit lokal mbi analizën paraprake për nevojat e komunitetit, ku janë përfshirë banorët e komunitetit lokal, shoqëria civile dhe institucionet lokale.

2.2 Indikator: Investimi në komunitet është harmonizuar me politikat, praktikat dhe programet tjera të ndërmarrjes.

Arsyetimi për indikatorin:

Indikatori duhet të tregojë se investimi është në linjë me politikat, praktikat dhe programet e brendshme të ndërmarrjes. Koordinimi i brendshëm në ndërmarrje është i rëndësishëm për veprim të harmonizuar të të gjitha departamenteve në ndërmarrje me aktorët lokal.

3. Bashkëpunimi me aktorët relevant në komunitet

3.1 Indikator: Investitori si partner i barabartë me partnerët e përfshirë, e jo si aktor kryesor.

Arsyetimi për indikatorin:

Indikatori duhet të tregojë se ndërmarrja pozicionohet si partnere në proceset e investimit, gjë që ka ndikim tek palët e interesuara, sesa si një aktor kryesor në nxitjen e zhvillimit lokal. Një qasje me shumë palë të interesuara redukton kontrollin e ndërmarrjes mbi investimin, por shton vlerat e pronësisë së përbashkët me partnerët lokalë dhe komplementaren rreth interesave të përbashkëta.

Botues: Fondacioni Albiz
www.albiz.org.mk
info@albiz.org.mk
+389 2 2057 632
rr.20, nr.97 Saraj, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut